

VENDIM
Nr.209, datë 21.4.2008

**PËR PËRFUNDIMIN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE PËRJASHTIMIN NGA SKEMA E
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË DEGËS NË TIRANË TË BANKËS SË PARË
TË INVESTIMEVE, TIRANË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 11, pika 2 (f), nenit 23, pika 5, shkronja “b”, dhe pika 6, si dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, si dhe mbështetur në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.28, datë 9.4.2008 “Për revokimin e licencës së Degës në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë”, vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.35, datë 27.6.2007 “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare “Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a.””, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ASD, Këshilli Drejtues i ASD-së

VENDOSI:

1. Të përfundojë sigurimin e depozitave në degën në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.35, datë 27.6.2007 “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare “Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a.””.

2. Të përjashtojë degën në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë nga skema e sigurimit të depozitave për shkak të revokimit të licencës së saj me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.28, datë 9.4.2008 “Për revokimin e licencës së degës në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë”.

3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Sktori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave) të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe degën në Tiranë të Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë për këtë vendim, si dhe të kërkojë nga Dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve, Tiranë dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave.

4. Ngarkohet zyra juridike për publikim e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES
Dashamir Halilaj